



Para-lajmërim i Ftesës për Aplikim për Raundin e 11-të, të Skemës së Celulës së të Rinjëve, Programi i BE-së për bursa post-diplomike 2018

NB: Ky është një para-lajmërim për të informuar lidhur me hapjen e ardhshme të ftesës për aplikim. Tani nuk kërkohet asnjë veprim nga aplikantët potencial.

Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe **Ministria e Integritimit Evropian**, paralajmërojnë hapjen e konkursit për Raundin e 11-të, të aplikimit për Skemës e Celulës së të Rinjëve, programi i BE-së për bursa post-diplomike për Kosovën, program i cili aktualisht është duke u zbatuar nga British Council. Aplikimi do të jetë i hapur nga **15 Janar 2018** deri më **5 Shkurt 2018** dhe kandidatëve të suksesshëm do t'iu ofrohet mundësia të aplikojnë për Programi Master në univerzitetet të shteteve anëtare të BE-së. Programi i Bursave, **gjuha e punës e së cilës është vetëm gjuha Angleze**, do të ofroj deri në 45 bursa të plota (numri real i bursave të ofruara mund të jetë më i vogël varësisht nga përshtatshmëria e kandidatëve dhe fondet në dispozicion). Kjo ftesë do të jetë e hapur për publikun e përgjithshëm dhe shërbyesit civil (deri në 10% të numrit të përgjithshëm të bursave të ofruara), për studentët e diplomuar në fakultetet si: juridik, shkencë politike, menaxhment i biznesit, shkencë shoqërore, histori, shkencë humane, marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci, kriminologji dhe fusha të tjera akademike (siç është specifikuar në Rregullat e Procedurës që do të publikohen më 15 janar 2018) në përputhje me sektorët e specializimit në vijim:

- ◇ **Juridik – deri në 25 bursa në dispozicion**
- ◇ **Administratë Publike - deri në 10 bursa në dispozicion**
- ◇ **Ekonomik - deri në 10 bursa në dispozicion**

Të drejtë konkurimi kanë aplikantët të cilët janë:

- ◇ **Banorë të Kosovës** me pasaportë të vlefshme të Kosovës apo me letërnjoftim të lëshuar nga Autoritetet Kosovare ose ata të cilët ofrojnë dëshmitë e lindjes dhe të vendbanimit në Kosovë (**vini re: çertifikata e lindjes dhe çertifikata e vendbanimit** të dyja kërkohen në rastet kur në asnjë mënyrë nuk mund të sigurohet letërnjoftimi).
- ◇ Të diplomuarit në njërin nga fushat e studimeve që i përkasin sektorëve (ju lutem referojuni Shtojcës I të Rregullave të Procedurës që do të publikohen më 15 janar 2018). Studentët të cilët janë në përfundim të fakultetit poashtu mund të kenë të drejtë konkurimi nëse marrin diplomën jo më vonë se 31 korrik 2018 (shikoni më lartë pikën I D) Kandidatët e Padiplomuar për detaje të mëtejme).
- ◇ **Flasin rrjedhshëm gjuhën angleze** dhe shqipe apo serbe. Njohja e gjuhëve tjera të BE-së nuk konsiderohet përparësi.
- ◇ Janë të gatshëm të udhëtojnë dhe të lëvizin jashtë vendit nga muaji Gusht 2018 deri në Tetor 2018 dhe të vijnë trajnime intenzive nga gjysma e muajit Mars 2018 e më tutje.
- ◇ Janë lindur më 4 Shkurt 1983 apo më vonë

Bursat do të mbulojnë shpenzimet për deri në **45 bursistë**, si në vijim:

- ◇ Shpenzimet e shkollimit
- ◇ Shpenzimet e jetesës
- ◇ Shpenzimet e vizës
- ◇ Sigurimin shëndetësor
- ◇ Biletat e udhëtimit
- ◇ Testin e gjuhës angleze IELTS (dhe testin GMAT nëse është e nevojshme)

Pjesëmarrësit e përzgjedhur do të zotohen të:

- ◇ Punojnë për Administratën Publike të Kosovës si praktikant për së paku dy muaj para nisjes (përveç shërbyesve civil të cilët veç janë të punësuar në Administratën Publike në Kosovë)
- ◇ Ndjekin Programin e Trajnimit të gjuhës në kuadër të YCS (ku është e nevojshme)
- ◇ Ndjekin dhe kryejnë studimet e zgjedhura post-diplomike
- ◇ Përbushin obligimin e punësimit apo ripunësimit (nëse janë shërbyes civil) të pandërprerë trevjeçar në Administratën Publike të Kosovës (përfshirë punësimin nëpër komuna dhe qeveri lokale, mundësisht në vendet e tyre të banimit), pas kthimit.

Përzgjedhja do të zhvillohet në tri faza dhe përfshinë:

- ◇ Para-përzgjedhja bazuar në kriteret administrative dhe të përzgjedhshmërisë
- ◇ Testet me shkrim (i njohjes së gjuhës angleze, njohjes së përgjithshme për BE-në, dhe vlerësimi verbal & numerik)
- ◇ Intervistë nga paneli i akademikëve evropianë. Përfaqësuesit e ZBE dhe të MIE do të marrin pjesë në panel si vëzhgues

Femrat dhe përfaqësuesit e minoriteteve fuqimisht inkurajohen të aplikojnë. Formularët e aplikimit dhe dokumentet tjera përcjellëse do të jenë të disponueshme për shkarkim nga interneti, në web faqen vijuese www.ycskosovo.eu duke filluar nga **15 Janar 2018**. Informatat shtesë mbi rregullat e skemës, procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes poashtu do të jenë online nga data e njejtë.

Ky është vetëm para-lajmërim për të informuar aplikantët potencial për hapjen e ardhshme të ftesës për aplikim. Aplikimi ende nuk është hapur.

Për më shumë informata www.ycskosovo.eu

"Skema e Celulës së të Rinjëve (Raundi XI-XII)" është projekt i financuar nga BE, menaxhuar nga ZBE dhe zbatuar nga British Council.

